



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:169178

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947985

K.DH.SH.II.nr.857/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “Euro Trans” me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Besim Curri, avokat, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.443/22 të datës 13.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.07.2024, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit, NTSH “Euro Trans” me seli në Podujevë, e datës 02.04.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.443/22 të datës 13.03.2024, **Vërtetohet**.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, NTSH “Euro Trans” me seli në Podujevë, nën pikë II. është lënë në fuqi aktvendimi nr.06.2/522/16 i datës 14.07.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, ndërsa nën pikën III, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit Doganor nr.03/L-109 dhe Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e ankuesit NTSH “Euro Trans” si e bazuar në dispozita ligjore, të anulohet aktgjykimi me nr. KF.nr.443/22 dhe aktvendimi i të paditurës 06.2/522/16 i datës 14.07.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe të mbetet në fuqi rivlerësimi i parë i mallit i kryer nga e paditura, Dogana e Kosovës/Sektori i Pranimit Qendror dhe i cili paraqet vlerën reale të mallit të importuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur nr.06.2/522/16 i datës 14.07.2021, është hequr masa e pezullimit sipas aktvendimit numër 01.3.2.2/591 e datës 06.03.2020 lidhur me kërkesën e subjektit “Euro Trans” Shpk- Prishtinë për rishqyrtimin e aktvendimit numër 04.1/306 datë 27.05.2016 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese, është refuzuar kërkesa e subjektit “Euro Trans” Shpk-Prishtinë për rishqyrtimin e aktvendimit numër 04.1/306 datë 27.05.2016 i lëshuar nga Sektori për Kontroll pas Importuese, dhe është lënë në fuqi aktvendimi numër 04.1/306 datë 27.05.2016 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatë. Dhoma e Shkallës së Parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesorë më dt.13.03.2024, në prani të përfaqësueseve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e

ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim se: Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, paragrafi. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas paragrafi. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit për shkelje të dispozitave të KDA-së, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale me arsyetimin e paditësit se zhdoganimi i mallit kontestues është bërë komfor nenit 66 të KDA-së, dhe nenit 123 të UA 11/2009, sipas dokumentacionit origjinal dhe të vërtetuar nga autoritetet e Republikës së Turqisë, ngase nga shkresat nr. parashtrësia e Republikës së Turqisë nr.273-41/41 e datës 16.11.2015, se bashku me procesverbalin i dorëzimit të librave dhe dokumenteve, procesverbalin për fillimin e hetimeve, parashtrësia e Republikës së Turqisë nr.AGB-A-3347/9-8 i datës 29.01.2016, parashtrësia e Republikës së Turqisë nr.113-15/15 datës 17.04.2015, është konfirmuar kërkesa e Doganës së Republikës së Kosovës, lidhur me verifikimet dhe vlerën e saktë të mallit të deklaruar me DUD-at kontestues e cila më pastaj sipas këtyre përgjigjeve dhe verifikimeve, është rregulluar situata me nxjerrjen e aktvendimit 04.1/306 datë 27.05.2016, nga kanë lindur edhe detyrimet doganore shtesë në shumë prej 66,254.13 euro për këtu paditësin. Tutje Gjykata edhe lidhur me pretendimin tjetër të paditësit se në rastin konkret duhet zbatuar dokumenti nga autoriteti tatimor i Republikës së Turqisë “vlerësim dhe konkluzion” i përkthyer në gjuhë zyrtare për gjykatën nuk paraqet rrethanë për të vendosur ndryshe nga ajo sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi, kjo ngase ky dokument si i tillë përveç që nuk i referohet këtu paditësit i njëjti nuk konstaton rregullsinë e dokumenteve dalëse nga Shteti i Turqisë, dokumente këto që si të tilla nuk janë deklaruar edhe tek autoritetet doganore të Shtetit të Kosovës, por se janë ndryshuar vlerat për qëllime të përfitimit nga detyrimet doganore në Import. Andaj bazuar në të dhënat dhe faktet si më lartë Gjykata e pranon konstatimin e bërë nga e paditura në arsyetim të aktvendimit kontestues si të rregullt dhe të bazuar në ligj ngase për mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim sipas DUD-ve Kontestues, nuk është deklaruar drejtë vlera e mallit për qëllime doganore, prandaj mbi bazën e ndryshimeve të bërë nga e paditura kanë lindur edhe detyrimet doganore shtesë në shumë prej 66,254.13 euro për këtu paditësin, taksa këto të cilat nuk janë paguar në momentin e importit, andaj në një situatë të tillë e bazuar në nenin

82, të KDA-së. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se me aktin administrativ të kontestuar është shkelur ligji në dëm të tij. Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr. 06.2/522/16 i datës 14.07.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të Doganës së Kosovës, nr.06.2/522/16 i datës 14.07.2021, të atakuar nga paditësi edhe në vështrim të dispozitave nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e Dhomës së Shkallës së Parë-Departamentit Fiskal sepse nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson se Organi administrativ, e në rastin konkret Dogana e Kosovës, në bazë të nenin 82 par 1 dhe 3 të KDA-së, i cili përcakton se: *“1. Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në*

*përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”, e që në këtë rast malli lëndorë të deklaruar për zhdoganim sipas DUD-ve kontestuese rezulton se nuk është deklaruar drejtë vlera e mallit për qëllime doganore, prandaj mbi bazën e ndryshimeve të bëra nga e paditura kanë lindur edhe detyrimet doganore shtesë në syhumë prej 66,254.13 euro për paditësin, takasa këto nuk janë paguar në momentin e importit, ashtu sipas konfirmimit nga Dogana e Kosovës lidhur me verifikimet dhe vlerën e saktë të deklaruar me DUD-at kontestues me të cilën është rregulluar situata sipas aktvendimit 04.1/306 datë 27.05.2016 .*

Kolegji, shqyrtoi pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është aplikuar e drejta materiale e po ashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë nga Dhoma e Shkallës së Parë dhe në organin përfundimtar të Doganës së Kosovës, se subjekti-paditësi përmes Deklaratave Unike Doganore të lartcekura gjatë procedurës së zhdoganimit ka nënvlerësuar mallrat lëndore duke deklaruar ose duke përdorur dokumentacion të dyfishtë ( vlera të ndryshme) me të cilin deklarim subjekti ka paguar taksa doganore në vlerë më të vogël nga vlera të cilën do ta paguante sikur të kishte paraqitur dokumentacion origjinal me të cilin malli lëndor ka dal nga shteti eksportues, mirëpo Sektori i Kontrollës pas importuese pas analizave të bëra dhe krahasimit të të dhënave për mallin e importuar përmes dokumenteve përcjellëse me të dhënat e Autoriteteve Doganore Turke, ka konstatuar se eksportuesi është i njëjtë, peshë të njëjtë dhe sasi të njëjtë të mallit mirëpo sa i përket vlera të deklaruar gjatë importit ato nuk përputhen, me c’ rast paditësi ka bërë deklarim të pa saktë të vlerës së mallit, ku ka deklaruar vlerë dukshëm më të ulët se vlerat e mallit sipas dokumenteve të autoriteteve Turke. Andaj, kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur i ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se nuk mund të veprohet sipas pretendimeve të paditësit që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar pasi që paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues.

Sa i përket pretendimit se Dhoma e Shkallës së Parë ka injoruar në tërësi ekzaminimin e çmimit të shitjes së këtij malli në tregun e Kosovës, pasi që e njëjta ka disponuar me librin e blerjes dhe atë të shitjes dhe ka mjaftuar vetëm një vlerësim të çmimit të shitjes më treg me çmim që përcaktohet tani dhe jemi të sigurt se do të shihej sheshazi veprimi i padrejtë i të paditurës. Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit pasi që paditësi as në procedurë administrative tek e paditura por as në konflikt administrativ gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi apo provë materiale, duke paraqitur dokumentacion të besueshëm e të harmonizuar, mbi bazën e të cilave prova paditësi do të ishte liruar nga pagesa e taksave doganore.

Pretendimet ankimore të paditësit, se Dhoma e Shkallës Dytë duhet të analizoj edhe njëherë dokumentacionin sidomos ekspertizën financiare dhe Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të vërtetoj faktin se vlerat fiktive a mund të jenë mbulesë për rivlerësim të dytë të mallit, gjithmonë duke pasur bindjen e plotë të ankuesit se vlerësimi paushall dhe jo në tërësi matëse është në kundërshtim të plotë me nenet 34, 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave ku kërkohet vlera e paguar dhe jo vlera fiktive e caktuar nga eksportuesi, kolegji këto pretendime i refuzon si të paqëndrueshme pasi që i shqyrtoi në baza ligjore si dhe nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur se ekzistojnë dëshmi që do të ndikonin në vendosjen ndryshe të çështjes, dhe se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, dhe as Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim. Nga shkresat e lëndës kolegji i kësaj gjykate vlerëson se paditësi nuk e ka provuar një gjendje tjetër faktike me të cilën do të vërtetonte se vlera e mallit doganor nga Turqia është vlerë reale e paraqitur pranë autoritetiteve doganore të Republikës së Kosovë, prandaj gjykata vlerëson se me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadin e paditësit dhe e paditura me aktin administrativ kontestues ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe

nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.857/24, me datë 16.07.2024

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri